

Njoftim për Shtyp

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave mirëpret ekspertët e misionin të TAIEX që do asistojnë në hartimin e planit të veprimit të Strategjisë së Biznesit të Doganave

05 Shkurt 2024

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave Z. Genti Gazheli priti sot në një takim misionin e ekspertëve të TAIEX, (*financuar nga Bashkimi Evropian*) përbërë nga z. Boris Kastelic, Drejtor i Departamentit të Doganave dhe Z. Branko Gregorič, Koordinator i Marrëdhënieve me Jashtë, në Ministrinë e Financave të Sllovenisë.

Qëllimi i këtij misioni është të ndihmojnë Administratën Doganore Shqiptare në përgatitjen e Planit të Veprimit të “**Strategjisë së Biznesit të Doganave 2023-2027**”, e hartuar gjithashtu me asistencën e Bashkimit Evropian (BE) me qëllim modernizimin e administratës doganore në funksion të lehtësimit të tregtisë.

Në fjalën e tij Z. Gazheli u shpreh se Doganat u vlerësuan maksimalisht nga Komisioni Evropian në procesin “*Screening*” dhe se prioritetet kryesore të Administratës Doganore për katër vitet e ardhshme janë **digjitalizimi** (sistemet e teknologjisë së informacionit dhe Inteligjencës Artificiale në vlerësimin e riskut) dhe **forcimi i kapaciteteve administrative** në procesin drejt një dogane moderne sipas standarteve të BE-së.

Ekspertët e TAIEX-i vlerësuan progresin e Shqipërisë në procesin e integritit kryesisht për kapitullin 29 “**Bashkimi Doganor**” si dhe theksuan se administrata doganore shqiptare duhet t’i përshtatet sfidave të bashkimit doganor me BE-në sipas praktikave më të mira.

Misioni i TAIEX do të konkludojë me datë 9 shkurt 2024 me hartimin e “**Planit të Zbatimit të Strategjisë së Biznesit të Doganave Shqiptare 2023-2027**” të fokusuar te lista e aktiviteteve kryesore, prioritetet dhe indikatorët e matshëm të zbatimit të Strategjisë.